

Me lejoni qe ne fillim t'ju falenderoj per pjesemarrjen ne kete debat lidhur me Procesin Gjyqesor ndaj liderit te Levizjes Vetevendosje , Albin Kurtit.Te nderuar profesore,i nderuar Staf Akademik te nderuar te pranishem,

Tashme te gjithë e dime se ne Kosove funksionon nje mision per ruajtjen e paqes dhe sigurise.Keshilli i Sigurimit duke patur parasysh parimet e Kartes se OKB dhe pergjegjesine primare te Keshillit te sigurimit per ruajtjen e paqes dhe sigurise nderkombetare,ne mbledhjen e 4011-te te mbajtur ne 10qershor 1999 miratoi Rezoluten 1244.Me ane te saj kerkoi nga Sekretari i Pergjithshem qe ne konsultim me keshillin e sigurimit te emeroje nje perfaqesues special per ta kontrolluar implementimin e misionit civil nderkombetar.

EULEX-i eshte misioni me i madh civil deri tani i politikës europiane te Mbrojtjes dhe Sigurise qe nepermjet monitorimit,mentorimit dhe keshillimit ne ceshtje te policise,gjyqesise si dhe ne dogana ka si qellim te forcoje sundimin e se drejtes ne institucionet e Kosoves.Aksioni i perbashket per themelim te EULEX-it si dhe Aksionin e Perbashket per emerimin e Piter Feith si Perfaqesues Special te UE-s per Kosoven u miratua nga Keshilli Evropian ne 4 shkurt 2008.

Keshtu UNMIK-u ne baze te Kartes se OK-se kete ceshtje e transferoi ne kompetencat e EULEX-it.

EULEX-i sot shtrin veprimtarine e tij ne me shume fusha,por nje nga segmentet me te rendesishme te misionit ka te beje me komponentin gjyqesor.Ne Programin strategjik te EULEX-it shohim se ne fushen penale ne nivel te gjykates se Qarkut jane vendosur 17 gjyqtare te EULEX-it,3 gjyqtare ne nivel te Gjykates supreme.Ne tere Kosoven ne Gjykatat e Qarkut do te vendosen 11 prokurore te EULEX it,Ne Zyren e prokurorise shteterore te Kosoves 1 prokuror

,ndersa 5 do te vendosen ne Zyren e Prokurorit special.

Liria e fjales ne thelb eshte liria e ankimit , sa here qe thuhet se mungon liria e fjales gjithmone fshihet liria e ankimit.

Nese arrijme te bejme nje pershkrim te shkurter se si ka rrjedhur ky proces,me zvarritjet dhe pezullimet ai pak a shume do te dukej keshtu:

Natyrisht se rifillimi i procesit gjyqesor kunder liderit te Levizjes Vetevendosja, Albin Kurti na ben te kujtojme edhe nje here ngjarjet e 10 shkurtit 2007, ditën kur Levizja Vetevendosja organizoi demonstrate paqesore ne Prishtine kunder Planit te Ahtisarit dhe per Vetevendosje ne Kosove. Gjate kesaj demonstrate policia rumune e UNMIK-ut ka qelluar e vrare dy persona, kurse mbi 80 te tjere jane plagosur.

Procesi gjyqesor filloi me arrestimin e Albin Kurtit po ne 10 shkurt, ku ai u mbajt ne burg per 5 muaj,e me pas ne burgim shtepiak i akuzuar per udheheqjen e mases qe ka kryer veper penale, thirrje per rezistence, pengim te personave zyrtar gjate kryerjes se detyrave te tyre.

Me pas Prokurori special i Unmikut, Robert Dini zhvilloi hetime lidhur me kete ceshtje dhe ne 6 prill te 2007 -es ka raportuar se provat nuk tregojne se viktimat te kene bere ndonje veprim per te rrezikuar jeten e ndonje zyrtari policor. Drejtimi i operacionit policor ate dite ishte vene nen duart e UNMIK-ut(misioni i Kombeve te Bashkuara ne Kosove) si pasoje e asaj se Ministri i Puneve te Brendshme dha doreheqje pas 10 shkurtit, kurse shefi i policise nderkombetare qe kishte drejtuar operacionin policor Stiven Kurtis dha doreheqje dhe gezon imunitet nga ndjekja penale. Keto hetime arriten ne perfundim se smund te vertetohej cilet pjestare te njesitet te policise rumune ishin pergjegjes.

Keshthu familjet e demtuara ankesen e tyre per te drejtat e njeriut e paraqiten prane Panelit Keshillues per te drejtat e njeriut. Ky panel lidhur me keto ankesa miratoi me 6 qershor 2008 nje vendim me te cilin i shpall te pranueshme ankesat e familjareve te te vrareve e te plagosurve. Paneli ka perfunduar se rasti ne fjale pretendohet te kete cenuar te drejten per jete, te drejten per degjim te drejte, te drejten per ankese, te ndaleses se tortures e trajtimit cnjerezor, te drejten per grumbullim te qete kane ngritur ceshtjet e ligjit dhe faktit dhe percaktimi i tyre duhet te varet nga ekzaminimi i fakteve mbi rastin.

Ne seancen e 19 shtatorit 2007 Albin Kurti nuk pranon asnje nga avokatet mbrojttes qe i cakton UNMIK-u, kurse me 7 shkurt 2008 ne seancen e 6 gjyqesore rasti u pezullua kur avokati i gjashte mbrojttes i Albin Kurtit i emeruar nga UNMIK-u nuk u paraqit ne gjyq.

Ne 24 janar 2010 Euleksi rifillon procesin gjyqesor. Zedhenesja e Euleksit, Karin Limdal ka konfirmuar se procesi do te filloj me 15 shkurt ne Gjykaten e Qarkut, ndersa seancat degjimore do te mbahen ne muajin shkurt dhe .Ajo nder te tjera thote se kjo eshte nje lende normale gjyqesore qe kerkon shqyrtim dhe se esgte trasheguar nga UNMIK-u. Zedhenesja Limdal ne Deklaraten e saj me shkrim thote se procesi do te zhvillohet nga nje panel i perzier gjykatesish, ndersa kryesues do te jete nje gjyqtar i Euleksit.

Si pasoje e mosparaqitjes se Albin Kurtit ne gjyq, gjykata ne Prishtine jep urdher per arrestimin e tij. Gjyqtari Ferdinando De Mongod ka thene se mosprania e te akuzuarit dhe mungesa e gjykateses vendase te panelit ka bere qe seanca te shtyhet. Gje qe eshte konfirmuar edhe nga zedhenesja e komponentes se drejtesise ne Eulex, Kristina Herodes qe eshte shprehur se kjo lende nuk mund te injorohet nga gjyqesori.

Pakenaqesite rreth ketij procesi i kane paraqitur edhe organizata e institucione vendase dhe nderkombetare, megjithate qytetaret e Kosoves nuk mund ti drejtohen Gjykates Evropiane per te drejtat e njeriut pasi Kosova nuk eshte anetare e Keshillit Evropian.

Prandaj me 11 shkurt 2010 u krijua keshilli kunder procesit gjyqesor ndaj AK, keshill ky qe perbehet nga nje numer organizatash e aktivistesh te shoqerise civile qe kerekojne mbylljen e procesit gjyqesor ndaj Albin Kurtit si dhe zhvillimin e hetimve per vrasjen e dy demonstruesve ne 10 shkurt 2007.

Mes tjerash ata thone se nuk duhet te keqperdoret as nga Unmiku as nga Euleksi pamundesia e qytetareve te Ks qe drejtesine si mjet I fundit juridik ta kerkojne ne Gjykatën Evropiane per te drejtat e njeriut ne Strasburg apo ne Komitetin per te drejtat e njeriut ne OKB.

Gjykimi i Albin Kurtit eshte shtyre per daten 13 Prill,te presim e te shohim ndoshta rrethana te tjera do te na cojne ne nje date tjeter pasi ne fund te fundit universi eshte shume kompleks ashtu si veprimet e njeriut jane shume ndryshme dhe te lira keshtuqe veshtire se mund ti kuptoje dikush plotesisht,ti parashikoje apo t'i udheheq.Liria lejon perparim te paimagjinueshem e te paparashikueshem.

Ju faleminderroj!